



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.10/23

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit “O....K...” Sh.p.k me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson avokatët Shkelëzen Sopjani dhe Arian Prebreza sipas autorizimit, ndaj kundërpropozuesi i masës së sigurimit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave dhe Transfereve, Agjencia Qendrore e Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ardi Mehmeti dhe Fation Alaj, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurisë, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Kosovë-Dhoma e Shkallës së Parë KE.nr.2048/22 e datës; 27.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën; 19.01.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e propozuesit të masës së sigurisë “O....K...” Sh.p.k me seli në Prizren, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale në Kosovë-Dhoma e Shkallës së Parë KE.nr.2048/22 e datës; 27.10.2022.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale në Kosovë-Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin ankimor KE.nr.2048/22 e datës; 27.10.2022, ka vendosur si në vijim;

“Refuzohet në tërësi si e pa bazuar propozimi i paditësit/propozuesit të sigurimit “O....K...” Sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe të I ndalohe të

paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave dhe Transfereve, Agjencia Qendrore e Prokurimit me seli në Prishtinë, që të ndërmarr çfarëdo veprimi tjetër duke përfshirë por mos u ndaluar në mos futjen e “O...K...” Sh.p.k, në listën e zezë, me të cilin do ti shkaktonte dëm të pariparushëm dhe do ta vente në vështirësi financiare duke rrezikuar edhe veprimtarinë afariste të tij, deri në zgjidhjen meritorë të këtij kontesti.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që ankesa të aprohet si e bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar të shfuqizohet, dhe ti ndalohet kundërshtarit I sigurimit që të paraqesë kërkesë në OSHP, në mënyra që propozuesi të mos ta futë në listën e zezë të tenderëve, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese.

Kundërpropozuesi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë, edhe pse e ka pranuar ankesën me datën 20.12.2022.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208, ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit “O...K...” Sh.p.k me seli në Prizren, në Gjykatës Komerciale në Kosovë-Dhoma e Shkallës së Parë, ka paraqitur padi dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit , me të cilën ka kërkuar që të caktohet me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe të i ndalohet të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave dhe Transfereve, Agjencia Qendrore e Prokurimit me seli në Prishtinë, që të ndërmarr çfarëdo veprimi tjetër duke përfshirë por mos u ndaluar në mos futjen e “O...K...” Sh.p.k, në listën e zezë, me të cilin do ti shkaktonte dëm të pariparushëm dhe do ta vente në vështirësi financiare duke rrezikuar edhe veprimtarinë afariste të tij, deri në zgjidhjen meritorë të këtij kontesti.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe pretendimet nga ndër-gjyqësit në seancën dëgjimore të datës 17.10.2022 sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe ka marr aktvendimin e ankimuar me arsyetim se nuk

është plotësuar asnjëra nga kushtet në mënyrë kumulative të parapara në nenin 297 të LPK-së, ngase propozuesi nuk ka ofruar prova bindëse me të cilat do të vërtetonte pretendimet e tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ndër të tjera ka shtuar se kërkesa e propozuesit të masës së sigurimit që të ndërmerret çfarëdo veprimi për futjen e propozuesit të sigurimit në listën e zezë të tenderëve, nuk gjen mbështetje ligjore, pasi që me dispozitën e nenit 99 par 2 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës është përcaktuar se “ *Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare*”, nga e cila rezulton se kundërshtari i masës së sigurimit nuk ka kompetencën ligjore për të vendosur për diskualifikimin e një operatori ekonomik, përkatësisht për të vendosur lidhur me kërkesën e propozuesit për mos përfshirjen –futjen në listën e zezë të operatorëve ekonomik, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas nenit 297 pikën 1) nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se; “*Masa e sigurimit mund të caktohet; a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit*”.

Bazuar në dispozitën e sipërcituara lidhur me caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e

kërkesës si dhe ta bëjë të besueshme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit e që në rastin konkret asnjëri nga kushtet ligjore nuk janë plotësuar. Për më tepër propozuesi me propozim ka kërkuar që kundërshtarit të sigurimit ti ndalohej që të ndërmarrë çfarëdo veprimi tjetër duke përfshirë por mos u ndaluar në mos futjen e O....K... Sh.p.k në listën e zezë, me të cilin do të shkaktonte dëm të pariparueshëm dhe do ta vinte në vështirësi financiare duke rrezikuar edhe veprimtarinë afariste të tij, ndërsa në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi e sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk ka ofruar prova bindëse lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tyre, e më të cilat do të vërtetonin pretendimet lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Po ashtu nuk plotësohet as kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurisë sepse paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë se kundërshtari i sigurimit do të mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet me fshehjen e saj me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave ose ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, pasi që siguria e kërkesëpadisë nuk vihet në dyshim për shkak se e paditura ka kredibilitet financiar të mjaftueshëm dhe një masë e tillë është e panevojshme.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ka gjetur se propozimi është i pabazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore të propozuesit të sigurimit por gjeti se të njëjtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së parë. Po ashtu pretendimet e paraqitura në ankesë paraqet element të vlerësimi të vet kërkesëpadisë me padi, e cila do shqyrtohen me rastin e vendosjes meritore.

Prandaj, bazuar në të lartëcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore në mënyrë kumulative të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pika a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë. Nga të cekurat më lartë e

në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.10/23 të datës; 19.01.2023

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri